

Workshop-i rajonal i Zyrës për Korrupsionin dhe Drogën pranë Kombeve të Bashkuara me temë “*Forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve supreme të auditimit dhe agjencive kundër korrupsionit*”

31 maj – 2 qershor

Në datat 31 maj – 2 qershor u zhvillua në Vjenë, workshop-i rajonal i Zyrës për Korrupsionin dhe Drogën pranë Kombeve të Bashkuara me temë “*Forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve supreme të auditimit dhe agjencive kundër korrupsionit*”, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të institucioneve supreme të auditimit dhe agjencive ligj-zbatuese në luftën kundër korrupsionit të shteteve si Shqipëria, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Bullgaria, Austria dhe Italia.

Në takimin e zhvilluar u theksua roli i rëndësishëm i institucioneve supreme të auditimit në luftën kundër korrupsionit dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm midis tyre dhe institucioneve ligj-zbatuese në kuadër të ushtrimit të veprimtarive institucionale.



Bazuar në informacionin e shkëmbyer midis pjesëmarrësve dhe diskutimeve mbi praktikën e mira ndërkombëtare, u ra dakort mbi nevojën e hartimit të një plani veprimi në kuadër të forcimit të bashkëpunimit midis institucioneve supreme të auditimit dhe agjencive kundër korrupsionit:

Këto prioritetë konsistojnë në:

- *Komunikimi i vazhdueshëm midis këtyre palëve në lidhje me raste specifike dhe përcjellja e informacionit në kohë sa më të shpejtë;*
- *Formalizimi i bashkëpunimit nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve të bashkëpunimit midis tyre;*
- *Organizimi i trajnimeve të përbashkëta duke patur fokusin te standardet ndërkombëtare;*
- *Dhënia e vëmendjes së veçantë nga ana e agjencive të luftës kundër korrupsionit të informacioneve dhe fakteve të evidentuara gjatë veprimtarisë audituese;*
- *Krijimi i grupeve të punës të përbashkëta në kuadër të kontrollit dhe monitorimit të veprimtarive publike;*
- *Hartimi i planeve të përbashkëta në kontrollin e veprimtarisë së institucioneve publike duke e bërë procesin më gjithëpërfshirës.*

Ky plan veprimi është një referencë e mirë për çdo memorandum bashkëpunimi midis KLSH-së dhe agjencive ligj-zbatuese në kuadër të një bashkëpunimi sa më efektiv.

Gjithashtu u evidentua qartë nevoja e zhvillimit në të ardhmen e takimeve të vazhdueshme të këtij formati, me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale në misionin e rëndësishëm të luftës ndaj fenomenit negativ të korrupsionit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë aktivitet nga z. Flavjo Xhuveli, Kryeauditues pranë Departamentit të Institucioneve Qendrore.